

URDHËR
Nr. 230, datë 5.10.2018

PËR DELEGIM TË PËRKOHSHËM TË KOMPETENCAVE

Në zbatim të nenit 28 dhe nenit 29, të Kodit të Procedurave Administrative, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 58, datë 29.1.2004, “Për organizimin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar”, të nenit 26 të Rregullores së Brendshme të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 1, datë 14.1.2015, “Për miratimin e rregullores së brendshme të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e përkohshëm të kompetencave të titullarit të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, me përjashtim të kompetencave, të cilat nuk delegohen dhe që janë të shprehura me ligj, drejtorit të Drejtorisë së Vettingut dhe Sigurimit Industrial, z. Mark Ndreca.

2. Ndër të tjera, z. Ndreca ngarkohet edhe me:

- Ndjekjen e detyrave të vendosura në planin mujor të muajit tetor 2018;

- Ndjekjen dhe zbatimin e “Rregullores për funksionimin dhe organizimin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar”, të ndryshuar.

3. Delegimin e përkohshëm të kompetencave të titullarit, në funksion të Kontrollit të Figurës së Subjekteve të Rivlerësimit, përgjegjësit të Sektorit për Kontrollin e Figurës së Subjekteve të Rivlerësimit, z. Adhurim Hasanaj.

4. Z. Adhurim Hasanaj i delegohen kompe-tencat si më poshtë:

a) Mbikëqyr dhe udhëzon grupin e punës për kontrollin e figurës së subjekteve të rivlerësimit gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij;

b) Përfaqëson grupin e punës në marrëdhëniet me:

- Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (KPK);

- Kolegjin e Apelimit (KA) dhe Komisionerët Publikë;

- Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM);

c) Organizon dhe drejton veprimtarinë e grupit të punës;

ç) Kryen çdo veprim tjetër të nevojshëm për realizimin e qëllimit, objektit dhe detyrave për të cilat është ngritur grupi i punës.

5. Mbledhjet e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar (KDZH) do të mbledhen sipas nevojës së procesit të rivlerësimit kalimtar nga nënkryetari i KDZH-së, në përputhje me vendimin nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për Deklasifikimin dhe Zhvlerësimin e Informacionit të Klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”.

6. Kompetencat e mësipërme delegohen për periudhën 8.10.2018 deri 12.10.2018.

7. Z. Ndreca dhe z. Hasanaj nuk mund t’i nëndelegojnë këto kompetenca.

8. Për ndjekjen e këtij urdhri ngarkohet drejtori i Drejtorisë së Vettingut dhe Sigurimit Industrial, z. Mark Ndreca.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen të gjithë nëpunësit/punonjësit e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.

10. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR
Dorian Tola